

Taksa dhe seleksionimi i mbeturinave



Çdo Komunë organizon mbledhjen dhe trajtimin e mbeturinave. Financimi i këtij shërbimi përfshin një taksë të qytetit (koshat e mbeturinave) që ndryshon nga një qytet në tjetrin. Për shembull, në Liège shuma që duhet të paguhet është 85€/ në vit për një person dhe 140€ për një familje. Kujdes, kjo taksë duhet të paguhet më 1 janar të vitit në vijim: nëse ndërroj adresë, unë duhet t' i paguaj Komunës për banesën e mëparshme.

Çdo familje duhet të seleksionojë mbeturinat sipas udhëzimeve të dhëna nga Komuna. Seleksionimi i mbeturinave është i detyrueshëm. Nëse nuk e respektoni mund të keni gjoba.

Të shumtën e kohës seleksionimi organizohet në këtë mënyrë:

Thasët me ngjyre të bardhë janë për mbeturinat shtëpiake që nuk mund të reciklohen. Thasët mirren çdo javë sipas planingut të komunikuar nga Komuna.



Një qese me ngjyrë tjetër është menduar për PMC (Plastikën, Metalet, Kutitë e kartonit): ne hedhim paketime plastike dhe shishe, kuti konservash, kanaçe, aerosole kozmetike dhe ushqimore, kartonat e pijeve (të quajtura edhe brick packs)... Asgjë tjetër nuk duhet hedhur brenda përndryshe do t'ju refuzohet. Thasët mblidhen rregullisht sipas një grafiku të komunikuar nga Komuna. Kujdes, në varësi të vendit ku unë jetoj, disa objekte plastike ose metali nuk mund të hidhen në PMC! Nëse kam ndonjë dyshim, unë iu referohem vizatimeve dhe shpjegimeve të shtypura në thesin PMC.



¹ Për të ardhurat më të ulëta, mund të bëhet një kërkesë përjashtimi.

Taksa dhe seleksionimi i mbeturinave



Letrat dhe kartonat duhet të ruhen veças. Ato duhet të jenë të lidhura mirë me spango ose ti vëni në një karton. Letrat janë gjithashtu të mbledhura çdo javë

sipas planingut të komunikura nga Komuna.



Objektet që pengojnë nuk mund të hidhen në koshin e mbeturinave. Një mbledhje e veçantë është planifikuar një herë në muaj ose me kërkesën në numrin e interesuar nga Komuna : objektet e mëdhaja, hekurinat, mobiljet, dyshekët,, nuk mund të lihen në vendet publike vetëm ditën kur mblidhen. Kujdes aparatat elektro shtëpiake, TV, radio, videoja, mbeturinat ndërtimore nuk janë të pranuar : ato duhet të lihen në një park për këtë gjë



Xhamat lihen në koshat e xhamave që i gjeni në vendet publike : kavanozat, shishet, shishet e vogla prej xhami hidhen bosh dhe të pastërta, duke ndarë xhamat e bardhë nga xhamat me ngjyrë.



Në disa komuna, kur paguaj taksën time të urbanizmit, unë marr bono për ti shndëruar me thasët e mbeturinave. Kur nuk kam thasë në stok, mundem ti blej në supermarketë dhe tjera vende shitjeje. Në komuna të tjera, egziston një sistem koshash me mikro procesorësh. Taksa ime e urbanizmit më autorizon një numër të kufizuar të mbledhjeve falas: jashtë kësaj kuote, unë paguaj tepricën e peshës. Formula të tjera egzistojnë për të kufizuar mbeturinat shtëpiake. Objektivi është me të vërtetë që të nxisim qytetarët të bëjnë sa më pak mbeturina.